




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT TIRANË

Nr. 12133 Regj. Themeltar  
Datë 25.03.2016 e Regjistrimit



V E N D I M  
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, e përbërë nga gjyqtarët :

**KRYESUESE : FJORALBA PRIFTI**  
**ANËTAR:     ARTUR MALAJ**  
**ANËTARE:    BLERONA HASA**

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Anjeza Bardulla**, sot në Tiranë, më datë 26.05.2016, shqyrtoi në dhomë këshillimi çështjen administrative me nr. 12133 regjistri themeltar, datë 25.03.2016 regjistrimi që i përket palëve:

**PADITËSE:**

Shoqëria Scholz sh.p.k, me seli ne kryesore ne Rruga e Fllakes, prane firmës Diamant, Xhafzotaj, Durrës, me NUIS K86625002F, me admnistrator Blazhe Mitrevski.

Shoqëria Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH, me seli në Am Bahnhof 73457 Essingen, Gjermani, përfaqësuar nga av. Neritan Kallfa me prokurë të posaçme.

**E PADITUR:**

Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR)

**PERSONI I TRETË:**

Gjovana Sokolaj

**OBJEKTI:** Shfuqizimin i pjesshëm të Aktit të QKR-së numër prot. 6796/1, datë 31.07.2015 sa lidhet me rrëzimin e ankimit për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave, në çështjen me numër CN- 159843—07-15.

Shfuqizimin e plotë të regjistrimit të aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07- 15.

Kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendje e mëparshme.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 7, 11/1, 15/a, 17/a e vijues i Ligjit 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" (në vijim Ligji 49/2012).  
Ligji nr. 8485 date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" (në vijim "Ligji 8485").  
Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, nenet 26, 27, 54/c), 71, 72/3 (në vijim referuar si "Ligji 9723").

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin Nr. 5376. Datë 27.10.2015 ka vendosur:**

1. *Pranimin e kërkesë padisë.*
2. *Shfuqizimin e plotë të regjistrimit të aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07-15.*
3. *Shfuqizim i pjesshëm i Aktit të QKR-së numër prot. 6796/1 datë 31.07.2015 sa lidhet me rrëzimin e ankimit për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave, në çështjen me numër CN-159843 – 07 - 15.*
4. *Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.*
5. *Ky vendim pasi merr formën e prerë përbënë titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm drejtpërdrejtë nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat ose Shtetëror.*

Ky vendim është ndrequr me vendimin e datës 25.11.2015 me të cilin është saktësuar emërtimi i subjektit procedural i palës paditëse nga Shoqëria Scholz sh.p.k në Shoqëria Scholz sh.p.k dhe Shoqëria Scholz Internationale Handelgesellschaft mbH.

**Kundër vendimit Nr. 5376 datë 27.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kanë paraqitur ankim pala paditur QKR , personi i tretë Gjovana Sokoli dhe kundërankim paditëses Shoqëria Scholz sh.p.k .**

**E padituara Qendra Kombëtare e Regjistrimit ka paraqitur ankimin më datë 11.11.2015 duke kërkuar:**

Prishjen e Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Nr. 80-2015-3666, datë 27/10/2015 dhe pushimin e çështjes bazuar në nenin 466/c, për shkaqet si më poshtë vijon:

*Së pari*, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, nuk ka zbatuar një prej parimeve kryesore atë të garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, parashikuar në nenin 14 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 40/4 i Ligjit nr. 49/2012.

*Së dyti*, vendimet janë marrë në zbatim të gabuar të Ligjit 9723/2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar, neni 27, 54, kreu VI dhe pika 19 e VKM nr. 506, datë 01.08.2007 "Për procedurat e regjistrimit dhe publikimit në QKR".

*Së treti*, gjykata ka anashkaluar në marrjen e vendimit zbatimin e Konventës së Hagës "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të 5 tetorit 1961.

Në ankim pala e paditur ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë, për faktin se nuk është kryer një hetim i plotë dhe i gjithanshëm, sipas nenit 14 të K.Pr. Civile. Gjykata nuk ka marrë parasysh ligjin, rrethanat e faktit dhe provat e ballafaquara gjatë procesit.

Sipas saj, gjykata duhet të kishte rrëzuar pretendim e paditëseve se vendimi i ortakut i datës 17.04.2014 dhe kontrata e shitjes 17.05.2014 të shoqëruara me vërtetim nënshkrimi noterial përpara noterit gjerman përfshirë edhe verifikimin si të tillë nga nëpunësi kompetent gjerman, duhet të ishin pranuar nga QKR vetëm të legalizuara nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Gjermani për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të nenit 27.3 të Ligjit nr. 9723/2007 "Për QKR".

Aktet rezultante të jenë redaktuara dhe prodhuara në shtetin Gjerman, janë dokumente të legalizuara nëntesisht të verifikueshme. Ato përmbajnë një vërtetim noterial, si dhe vulën dhe nënshkrimin e presidentit të Gjykatës së Landit Unkel, i cili ka vërtetuar origjinalitetin e nënshkrimit të noterës Sandra Buhler në Abtsmund dhe vulës së shërbimit.

Në ankim pala e paditur i referohet përcaktimeve të nenit 27 pika 4 të ligjit 9723/2007 sipas të cilit përcaktohet se: "Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja, duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë."

Shqipëria është anëtare e Konventës së Hagës "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të 5 tetorit 1961, të cilën e ka ratifikuar më 08 maj të vitit 2003. QKR në referim të nenit 116 të Kushtetutës së Shqipërisë parashtron hierarkinë e akteve ligjore që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ku në renditje e para është Kushtetuta, e dyta marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, e treta ligjet dhe e katërta aktet normative të Këshillit të Ministrave.

QKR parashtron se Konventa e Hagës është një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar nga shteti Shqiptar, i cili ka pranuar të plotësojë kushtet e vendosura për legalizimin e dokumenteve shqiptare dhe dokumenteve të shteteve të tjera anëtare të kësaj marrëveshje.

Për rrjedhojë dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore, ndërkohë nuk merr parasysh faktin se Shqipëria dhe shteti Gjerman janë anëtare të Konventës dhe dokumentet shqiptare dhe gjermane prodhojnë efekte në të dyja autoritetet pa legalizimin e përfaqësive diplomatike e konsullore. Legalizimi i dokumenteve të prodhuara në shtetin Gjerman pranohen nga institucionet publike brenda territorit të Shqipërisë pa legalizimin e përfaqësive diplomatike, sipas nenit 12 të konventës.

Gjykata nuk ka vlerësuar përmbajtjen e dokumentit të datës 14 tetor 2015, të Ambasadës të Republikës Federale Gjermane (i cili nuk u pranua nga gjykata), protokolluar me nr. 202/ 1 datë 10.01.2011, drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me lëndë "Mbi kërkesën tuaj për bashkëpunim". Në këtë shkresë thuhet se: "*Shqipëria ashtu si Gjermania është shtet anëtar i Konventës së Hagës të datës 05.10.1961 "Për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja". Për dokumentet e lëshuara në Gjermani, nevojitet një shënim mbi vërtetësinë, nga presidenti i një gjykate të Land-it në rajonin në të cilin ndodhet.*"

Sikurse është parashtruar më lart, kontrata shitblerjes së kuotave dhe vendimi i ortakut të vetëm kanë nënshkrimin e presidentit të Gjykatës së Landit Unkel. Në rastet kur nuk gjen zbatim Konventa e Hagës, për shtetet të cilat nuk janë anëtare të saj, atëherë do të zbatohet VKM 134, datë 07.03.2003.

Pranimi i dokumentacionit për aplikim është kryer sipas parashikimeve ligjore. Në këto kushte vendimi i gjykatës është në interpretim të gabuar të nenit 27 dhe 54 të ligjit 27,54 dhe pika 19 e VKM nr. 506, datë 01.08.2007 "Për procedurat e regjistrimit dhe publikimit në QKR".

Në nenin 27/2 QKR përcaktohet se dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë sporteleve të shërbimit në kopje të panjësuar apo në format elektronik bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin.

Aktet e shoqërisë, vendimi i ortakut 17.04.2014 dhe kontrata e shitjes 17.05.2014 janë dorëzuar tek nëpunësi i sportelit. Aplikimi dhe dokumentet shoqëruese kanë kaluar për shqyrtim e vendimmarrje tek nëpunësit e autorizuar, në format elektronik. Është përgjegjësi e aplikantit për të konfirmuar dokumentacionin shoqërues dhe jo e nëpunësit të QKR-së.

Vendimi i ortakut dhe kontrata e shitjes në format elektronik, nuk përmban asnjë shënim nga personi që i ka paraqitur për të konfirmuar njësinë e kopjes me origjinalin, çfarë vërteton faktin se dokumentet janë dorëzuar në origjinal nga aplikanti.

Pika 2 e nenit 54 e ligjit 9723/2007, i jep të drejtë nëpunësit të autorizuar, që të mos shqyrtojë saktësinë e të dhënave, vërtetësinë e dokumenteve, që i bashkëlidhen aplikimit, për regjistrim, apo përputhshmërisë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi. Regjistrimi dhe dorëzimi i dokumentacionit bëhet me vetë-deklarim nga vetë subjekti.

**Me ankimin saj personi i tretë Gjovana Sokolaj, e cila ka kërkuar:**

**Pranimin e ankimit dhe shqyrtimin në themel të çështjes dhe rrëzimin e padisë si të pambështetur në ligj dhe në prova dhe ngarkimin e paditëseve me pagimin e shpenzimeve gjyqësore.**

Më datë 03.11.2015 personi i tretë ka paraqitur me shkrim se kishte ankim kundër vendimit nr. 5376, datë 27.11.2015, ndërkohë që sipas shënimit të postës ka depozituar ankim më 10.11.2015, ankim, i cili ka mbërritur në sekretari më 12.11.2015.

Në ankimin e saj personi i tretë Gjovana Sokolo ka parashtruar këto shkaqe:

Vendimi i gjykatës administrative nr 5376 datë 27.10.2015 është dhënë në shkelje të hapur të ligjit nr. 9723/2007 të ligj

jit "Për QKR". Aplikimi për regjistrim pranë QKR-së është bërë nga ortakja e shoqërisë Gjovana Sokolaj, në përputhje me nenet 26 e 27 të ligjit për QKR. Dokumentacioni është dorëzuar fotokopje e noterizuar dhe ka vulën e nënshkrimit të Presidentit të Gjykatës së Landit Unkel, i cili ka vërtetuar origjinalitetin e nënshkrimit të noterës Sandra Buhler në Abtsmund dhe vulës së shërbimit. Gjithashtu vërtetohet se i sipërpërmenduri e ka kompetencën për të ndërmarrë këtë akt zyrtar, dokumentacioni është dorëzuar në përgjegjësinë e plotë të aplikueses dhe është i legalizuar sipas ligjit. 9060, datë 08.05.2003 Për aderimin e Shqipërisë në "Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Në këto rrethana vendimi është dhënë në shkelje të hapur të Konventës së Hagës "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" si dhe në shkelje të hapur të K.Pr.C për sa i përket legjitimitetit pasi nuk ka thirrur me cilësinë e personit të tretë ortakun Doni Sokolaj.

Vendimi është shpallur i pa arsyetuar nga gjykata në shkelje të ligjit 49/2012 Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Ai nuk ka asnjë argument ligjor në lidhje me konkluzionin përfundimtar, por është kopje e padisë.

Gjykata i ka mohuar personit të tretë ortakut Doni Sokolaj të drejtën e mbrojtjes dhe dëgjimit para Gjykatës në mbrojtjen e interesave pasurore dhe të drejtave të tij.

Personi i tretë në këtë gjykim, Gjovana Sokolaj dhe Doni Sokolaj në datë 17.04.2014 me paditësin kanë nënshkruar një kontratë nga ku rezulton blerja e 25% të kuotave Doni Sokolaj dhe 25% Gjovana Sokolaj. Në po të njëjtën datë është bërë edhe vendimi i ndarjes së shoqërisë sipas kuotave të shpërndara nga ortakut i vetëm Shoqëria Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH.

Personi i tretë parashtron se në cilësinë e ortakës së shoqërisë "Scholz Shpk" është në të njëjtën pozitë me Shoqërinë Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH me seli në Am Bahnhof edhe Doni Sokolaj. Në këto kushte personi i tretë është ortakë e Shoqërisë "Scholz Shpk" dhe të gjithë tërheqin interesa të ligjshme në këtë proces.

Shoqëria Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH me seli në Am Bahnhof, me cilësinë e ortakut nuk legjitimohet në kërkimin e saj. Administratori i shoqërisë "Scholz Shpk", është përfaqësues ligjor i shoqërisë, dhe si i tillë është edhe përfaqësues i personit të tretë Gjovana Sokolaj dhe Doni Sokolaj.

Administratori si përfaqësues ligjor i Shoqërinë, nuk rezulton të ketë një vendim të asamblesë së ortakëve për kundërshtimin e kuotave apo pavlefshmërinë e kuotave.

Është përgjegjësi direkte e administratorit fakti që nuk ka bërë aplikimin në QKR të ndryshimeve në Statut dhe të shitjes së kuotave dhe për këtë do të mbaj përgjegjësi ligjore sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 7638, Datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

Në kushtet e abuzimeve të shpeshta dhe të herëpashershme dhe shkeljeve të detyrimeve ligjore ka kërkuar shkarkimin e administratorit duke njoftuar për takim të asamblesë, por ende nuk janë lajmëruar për takim.

Sipas ankueses nuk ka asnjë akt që të deklarojë të pavlefshme kontratën e shitjes së kuotave, kështu që administratori nuk legjitimohet në këtë kërkim si përfaqësues ligjor i shoqërisë, edhe për këtë shkak padia duhet të rrëzohet.

Në vijim të ankimit personi i tretë ka kryer një përkthim të aplikimit dhe veprimeve të kryera pranë QKR për regjistrimin e kuotave në zbatim të nenit 26/3 të ligjit 9723/2007. Arsyeja e aplikimit është për shkak të depozitimit të vendimit, datë 17.04.2014, ku është vendosur miratimi i shitjes së 50% të kuotave të kapitalit nga shoqëria "Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH", në favor të Z. Doni Sokolaj 25% dhe Gjovana Sokolaj 25%.

Ankuesja ka parashtruar gjithashtu se aplikimi pranë QKR është kryer në përputhje me përcaktimet e neneve 26 dhe 27 të ligjit 9723/2007. Dokumentet bashkangjitur aplikimit kanë qenë në formën e kërkuar nga ligji, ato janë paraqitur të përkthyer dhe kanë vulën e nënshkrimit të Presidentit të Gjykatës së Lartë Unkel, i cili ka vërtetuar origjinalin e nënshkrimit të noteres Sandra Buhler në Abtsmund dhe vulës së shërbimit. Gjithashtu vërtetohet se i sipërpërmenduri e ka kompetencën për të ndërmarrë këtë akt zyrtar.

Sipas saj duke qenë se Shqipëria është anëtare e Konventës së Hagës "Për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja" të datës 5 tetorit 1961, dokumentet shqiptare që do të përdoren në vendet anëtare të së njëjtës Konventë, si dhe anasjelltas, nuk do të legalizohen nga përfaqësitë diplomatike e konsullore, pasi në zbatim të nenit 12 të kësaj Konvente, përjashtohen nga aplikimi i Apostille-s dokumentet për/nga Belgjika, Greqia, Gjermania, dhe Spanja.

Bëjnë përjashtim gjithashtu rastet kur dokumentet shkojnë /vijnë nga vendet që nuk janë anëtare të Konventës së sipërpërmendur.

Administratori i Scholz sh.p.k nuk legjitimohet në ngritjen e padisë pasi nuk mund të përfaqësojë interesin e një ortaku në emër e për interes të të gjithë shoqërisë.

Sipas neneve 71, 72 si dhe neneve 27, 54 të ligjit për QKR përcaktohet se QKR duhet të verifikojë dokumentacionin shoqërues të aplikimit vetëm për sa iu përket elementeve formale të tyre, ndërkohë që ajo ndalohe të shqyrtojë, ligjshmërinë, saktësinë e të dhënave apo vërtetësinë e dokumenteve që i bashkëngjiten aplikimit. . Plotësimi i aplikimit në formën e kërkuar nga ligji, si dhe paraqitja e dokumenteve shoqëruese, që provojnë të dhënat që kërkohen të regjistruohen, komform nenit 54, detyron QKR-në të kryejë regjistrimin në regjistrin tregtar, siç parashikohet edhe në nenin 55.2 të ligjit.

Nisur nga arsyetimi i mësipërm edhe ankimet administrative lidhur me regjistrimin e TREA nga shoqëria SCHOLZ Sh.p.k mund t'i drejtoheshin Drejtorit të Përgjithshëm të QKR-së, vetëm për shkaqe të shkeljes së dispozitave të këtij ligji.

Ankuesi përcakton se paditësi në fakt, ka pretenduar në thelb pavlefshmërinë e vendimeve të Mbledhjes së Aksionarëve të Shoqërisë, (akte private) vendime të cilat janë regjistruar nga QKR. Nëpërmjet ankimit janë kundërshtuar pretendimet e paditësit se akti i QKR-se është tërësisht në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore në fuqi dhe dokumentet e depozituara në QKR nga ana e aplikueses Gjovana Sokolaj nuk janë në formën e kërkuar nga ligji.

Sipas ankueses, akti " Vendim Nr. 6796/ 1 datë 31.07.2015 i QKR-së ", është i bazuar në nenin 71 të ligjit 9723/2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Nisur nga natyra funksionale që ka QKR, në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr. 9273/2007, e ka të ndaluar t'i hyjë përmbajtjes së dokumenteve, në zbatim të nenit 54/2, për procedurën e regjistrimit ligjvënësi ka parashikuar se nëpunësi i autorizuar nuk mundë të shqyrtojë saktësinë e të dhënave, vërtetësinë e dokumenteve që i bashkëlidhen aplikimit për regjistrim, apo përputhshmërinë e përmbajtjes së tyre me kërkesat e ligjit në fuqi.

Në rastin konkret dokumentet shoqëruese janë paraqitur në QKR nga znj. Gjovana Sokolaj, e cila nëpërmjet aktit të dorëzimit konfirmon njësinë e kopjes me origjinalin. Në rastin konkret aplikimi për regjistrimin e kuotave mund të kryhet nga ortaku, të cilit i përkasin kuotat në referim të neneve 26/3 dhe 27 të ligjit 9723/2007.

Ne referim të nenit 27.4 të ligjit 9723/2007 dokumentet e paraqitura për regjistrim plotësonin kushtet formale pasi vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë dhe kontrata e shitjes së kuotave përmbajnë një vërtetim noterial si dhe vulën e nënshkrimit të Presidentit të Gjykatës së Landit Unkel, i cili ka vërtetuar orgjinalitetin e nënshkrimit të noteres Sandra Buhler në Abtsmund dhe vulës së shërbimit.

Në kushtet kur Shqipëria është anëtare e konventës së Hagës të datës 5 tetor 1961, për heqjen e detyrimit të legalizimit të dokumenteve zyrtare të huaja, rezulton se nuk përbën detyrim legalizimi i dokumenteve të huaja dhe anasjelltas nga përfaqësitë diplomatike konsullore. Nga përmbajtja e nenit 12 të Konventës përjashtohen nga aplikimi i Apostille –s dokumentet për/nga Belgjika, Greqia, Gjermania dhe Spanja. Bëjnë përjashtim dokumentet të cilat shkojnë në/ vijnë nga vendet të cilat nuk janë anëtare e konventës së sipërpërmendur.

Duke qenë se Shqipëria ka aderuar në konventë me ligjin 9060, datë 08.05.2003, referuar nenit 116 "Aktet normative" të Kushtetutës së Shqipërisë, në rastin konkret ka përparësi "Konventa për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja" dhe jo VKM 134, i datës 07.03.2003.

Sipas ankueses, gjykata në kundërshtim me Kushtetutën i jep përparësi një VKM-je , e cila ka shërbyer për zgjidhjen e një situatë kalimtare.

Me vendimin e datës 12.11.2015 të gjykatës së shkallës së parë është vendosur pranimi i ankimit të palës së tretë ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë nr. 5376. Datë 27.10.2015.

Më datë 13.01.2016, paditëset "Scholz" Sh.p.k. dhe "Scholz Internacionale Handelsgesellschaft" mbH kanë paraqitur kundërankim kundër ankimit të personit të tretë Gjovana Sokolaj. Me kundërankimin e tyre ato kanë kërkuar:

Mospranimi i ankimit të paraqitur nga pala e tretë Gjovana Sokolaj kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. elektronik 80-2015-3666, me nr. çështjeje 31010-05178-80-2015, datë 27.10.2015 dhe lënien në fuqi të tij duke parashtruar këto shkaqe:

**Së pari:** Ankimi i paraqitur nga personi i tretë është paraqitur tej afatit të parashikuar nga ligji. Ankimi është regjistruar në sekretarinë e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me numër protokollit 12436, datë 12.11.2015, ndërsa vendimi i gjykatës është shpallur më datë 27.10.2015, duke u paraqitur në këtë menyrë tej afatit prekluziv të parashikuar nga nenet 443 dhe 44 të Kodit të Procedurës Civile, brenda 15 ditësh nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Në këtë kuptim nuk plotësohen kushtet për pranimin e ankimit si ankim i paraqitur jashtë afatit.

**Së dyti:** Nuk qëndron argumentimi në ankim se dokumentacioni i paraqitur në QKR nga aplikuesja Gjovana Sokolaj në çështjen me nr. C-159843-07-15 është i legalizuar konform Ligjit Nr. 9060 date 08.05.2003 "Për aderimin e Shqipërisë në "Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja".

Në arsyetimin e saj pala paditëse i referohet përcaktimeve të nenit 12 të Konventës Aposille si dhe VKM Nr. 134, date 7.3.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit."

Kundër ankuesi ka parashtruar se dokumentacioni shoqëruar i aplikimit (Vendimi i Ortakut të Vetëm dhe Kontrata e Shitblerjes së Kuotave) të shoqëruara me vërtetim nënshkrimi noterial përpara noterit gjerman përfshirë edhe verifikimin si të tillë nga nëpunësi kompetent gjerman, duhej të ishin shoqëruar dhe me vërtetim të legalizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Gjermani, duke qenë se në referim të nenit 12 të Konventës për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja , Gjermania ka paraqitur kundërshtim përkundrejt aderimit të Shqipërisë dhe për pasojë dokumentet zyrtare referuar edhe parimit të reciprocitetit do t'i nënshtrohen legalizimit diplomatik apo konsullor sipas pikës 4 të VKM-së Nr. 134, datë 7.3.2003 "Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit."

Në këto rrethana sipas paditëseve , dokumentet e paraqitura për regjistrim në QKR nuk përmbushnin kriteret e nenit 27.4 të Ligjit nr. 9723, i cili përcakton se: "*Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Se bashku me dokumentin shoqëruar në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të*

*legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”*

Në kundërankim , parashtrohet se personi i tretë në ankimin e paraqitur prej tij, nuk pretendon që dokumentet e paraqitura në çështjen me numër CN-159843-07-15 regjistrimi në sistemin e QKR, të kenë qenë pajisur as me vule apostille dhe as me legalizimin e Ambasadës Shqiptare në Gjermani, por thjesht pretendon se këto nuk aplikohen në rastin konkret.

**Së treti:** Nuk qëndron argumentimi në ankim së dokumentet shoqëruese janë në përputhje me nenin 27.2 të ligjit 9723 për shkak se dokumentacioni i paraqitur nuk është në përputhje me kërkesat ligjore të formës së dokumentit në “origjinal”, “njësia me origjinalin” apo fotokopje apo “kopje elektronike” e vërtetuar nga aplikanti.

Referuar prapësimeve të paraqitura në proces, QKR-ja nuk deklaroi nëse dokumentet ka qenë në origjinal, apo fotokopje dhe nëse aplikuesi ka bërë një deklaram të tilla për të vërtetuar dhe në çfarë forme janë paraqitur dokumentet, pasi nga aktet ky lloj vërtetimi nuk është bërë as në çdo fletë, as në fund të dokumentit. Deklarata e përgjegjësive nuk është plotësuar nga aplikuesja .

Pala e tretë nuk deklaroi nëse dokumenti ka qenë në origjinal, apo fotokopje, por mjaftohet me pretendimin se “dokumentet shoqëruese janë paraqitur në QKR nga znj. Gjovana Sokolaj, e cila nëpërmjet aktit të dorëzimit konfirmon njësinë e kopjes me origjinalin”.

Gjithashtu nga ana e aplikueses, Pale e Tretë në këtë proces, nuk rezulton të jetë “konfirmuar njësia e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin”, sipas përcaktimit nenin 27.2 të Ligjit nr. 9723.

**Së katërti:** Nuk qëndron argumentimi në ankim në lidhje me mungesën e legjitimitetit të paditësve.

Kundër ankuesi i referohet përcaktimeve të nenit 15/a dhe 17/a të ligjit 49/2012. Në rastin objekt gjykimi padia është ngritur nga **Scholz Shpk**, është shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 25.04.2008, me NIPT K86625002F, (më poshtë referuar si "Shoqëria" ose "Scholz Shqiperi"), e cila operon në tregun shqiptar të grumbullimit, përpunimit, riciklimit, tranizimit, transportimit dhe eksportimit të mbetjeve të ngurta dhe të vëllimshme me përmbajtje metalore. **Shoqëria Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH**, është shoqëri e së drejtës gjermane dhe është Ortaku i vetëm i Shoqërisë. Kundër ankuesi parashtron se në proces është provuar dhe argumentuar me prova shkresore se akti administrativ objekt gjykimi është nxjerrë në shkelje të ligjit më pasojë cenimin e interesave pasurorë të paditësit, të mbrojtura e garantuara me ligj, rrethanë që ka detyruar paditësit të kërkojnë shfuqizimin pjesërisht të aktit administrativ objekt kundërshtimi sipas kërkesë padisë.

Nga ana tjetër paditëset theksojnë se kërkesa ankimore ka qenë e lidhur me elemente që kanë të bëjnë me formën e dokumenteve dhe jo me përmbajtjen e tyre. Përmbajtja e dokumenteve do të ndjekë procedurat pranë organeve kompetente.

**Së pesti:** Kundër ankuesi ka pretenduar se nuk qëndron argumentimi i paraqitur në ankim në lidhje me nevojën e thirrjes së personit të tretë Doni Sokolaj në proces, për shkak se në objektin e padisë kërkohet që të shfuqizohet regjistrimi i aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07-15, aplikimi pranë QKR, për të cilën gjykata e shkallës së parë ka disponuar me thirrjen në cilësinë e personit të tretë, duke qenë se në cilësinë e aplikuesit në QKR ka interes direkt, ndërsa sa i përket pretendimit për thirrjen në gjykim si palë të shtetasit Doni Sokolaj, ky pretendim nuk ka asnjë argument ligjor, pasi ky person nuk rezulton të ketë kryer asnjë aplikim pranë QKR-së.



Paditëset rezultojn të ketë paraqitur kundër ankimit ndaj ankimit të kryer nga QKR. Rezultojn se njoftimi i paditësit mbi ankimin e QKR është kryer me dëftesën e komunikimit të nënshkruar në datën 07.01.2016. Kundër ankimit rezultojn të jetë dorëzuar në datën 24 shkurt 2016.

Në kundër ankimit kërkohet lënien në fuqi të Vendimit Nr. 80-2015-3666, me nr. çështjeje 31010-05178-80-2015, datë 27.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Nga përmbajtja e kundër ankimit rezultojn të jenë parashtruar të njëjtat arsyetime dhe argumenta sikurse u parashtruar në kundër ankimin e kryer ndaj ankimit të personit të tretë Gjovana Sokolaj.

Me vendimin e datës 11.11.2015 Gjykata e Shkallës së Parë administrative ka vendosur pranimin e ankimit të palës së paditur ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë Nr. 5376, datë 27.10.2014.

### GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi u njoh me relacionin e gjyqtares Fjoralba Prifti,  
u njoh

me ankimin e Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me të cilin është kërkuar: Prishja e vendimit Nr. 5376, datë 27.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimi i kërkesë padisë,

me ankimin e paraqitur nga personi i tretë Gjovana Sokolaj, me të cilin është kërkuar:  
Pranimi i ankimit dhe rrëzimi i padisë

me kundërankimet e paditëseve "Scholz" Sh.p.k. dhe "Scholz Internationale Handelsgesellschaft" mbH me të cilët është kërkuar:

Mospranimi i ankimit të personit të tretë Gjovana Sokolaj dhe Lënia në fuqi e vendimit Nr. 5376, datë 27.10.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe pasi u verifikuan kushtet e pranueshmërisë së ankimeve të paraqitura.

### VËREN

Se Gjykata Administrative e Apelit ka marrë në shqyrtim çështjen mbi ankimin e palës së paditur QKR dhe personit të tretë Gjovana Sokolaj, të cilët kundërshtojnë vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me të cilin është vendosur pranimi i kërkesë padisë së paditëseve shoqërive "Scholz" Sh.p.k. dhe "Scholz Internationale Handelsgesellschaft" mbH, shfuqizimi i plotë i regjistrimit të aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07-15 si dhe shfuqizim i pjesshëm i Aktit të QKR-së numër prot. 6796/1 datë 31.07.2015 sa lidhet me rrëzimin e ankimit për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave, në çështjen me numër CN-159843 - 07 - 15.

#### • Rrethanat e çështjes.

Nga shqyrtimi akteve të dosjes gjyqësore rezultojn se:

Sipas të dhënave të ekstraktit të QKR-së, datë 20.08.2015 rezulton se Shoqëria Scholz Shpk, është regjistruar me nr. NUIS K86625002 F. Ajo është shoqëri e së drejtës shqiptare e regjistruar në Regjistrin Tregtar më datë 25.04.2008 dhe operon në tregun shqiptar të grumbullimit, përpunimit, riciklimit, tranizimit, transportimit dhe eksportimit të mbetjeve të ngurta dhe të vëllimshme me përmbajtje metalore.

Shoqëria Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH, është shoqëri e së drejtës gjermane, dhe është Ortaku i vetëm i shoqërisë Scholz Shpk.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar, shoqëria ka pasur ndryshime në përcaktimin e kapitalit, shitjet dhe blerjet e kuotave si dhe ndryshime të tjera të cilat kanë sjellë si pasojë kryerjen e veprimeve pranë autoritetit QKR.

Personi i tretë Gjovana Sokolaj në datën 21.07.2015 ka aplikuar pranë palës së paditur QKR për regjistrimin e disa ndryshime dhe veprimeve. Respektivisht është dorëzuar dokumentacioni dhe është kërkuar të kryhen regjistrimet si më poshtë:

- a) transferimi i kuotave të kapitalit;
- b) mandati në para apo vërtetimit të noterit për pagesën e kapitalit në para;
- c) vendimi i asamblesë së përgjithshme;
- d) çdo regjistrim tjetër i të dhënave të regjistruara;
- e) dokumenti ri-identifikimit të përfaqësuesit ose vendimi i gjykatës për ndryshimin e emrit.

Në vijim të këtij aplikimi dhe në kuadër të dorëzimit të dokumenteve për regjistrim nga ana e palës paditëse QKR janë pranuar të gjitha aktet në dorëzim dhe janë kryer veprimet respektive në regjistrin kombëtar lidhur me të dhënat e shoqërisë Scholz Shpk.

Nga të dhënat që rezultojnë në ekstraktin e QKR, rezulton se në datë 24.07.2015 pranë QKR-së është regjistruar aplikimi i kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07-15, për ndryshime në të dhënat e regjistrimit të Scholz sh.p.k, si më poshtë:

*Arsyet e hapjes së çështjes: Depozitim i vendimit, datë 17.04.2014, ku është vendosur miratimi i shitjes së 50% të kuotave të kapitalit nga shoqëria "Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH", në favor të Z. Doni Sokolaj 25% dhe Znj. Gjovana Sokolaj 25%.*

*Depozitimi i Kontratës së Shitjes datë 17.05.2014.*

*Emri i Subjektit ishte ("SCHOLZ") u bë ("Scholz & Sokolaj GROUP")*

*Numri i aksioneve ishte "1,00" u bë "3,00"*

*Vlera e aksionit ishte "100.000,00" u bë "33.333,33"*

*Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortakët individ:*

*është shtuar ortakë: ("Doni Sokolaj") Numri i aksioneve "1,00" Përqindja në kapital "25,00"*

*Kontributi në para "25.000,00" është shtuar ortakë: ("Gjovana Sokolaj") Numri i aksioneve "1,00" Përqindja në kapital "25,00" Kontributi në para "25.000,00"*

*Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme tek ortakët juridik:*

*Kanë ndryshuar të dhënat për ("Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH"), Kontributi në para ishte ("100.000,00") u bë ("50.000,00")*

*Kanë ndryshuar të dhënat për ("Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH"), Përqindja në kapital ishte ("100,00") u bë ("50.000,00")*

Lista e Dokumenteve:

*Transferim i kuotave të kapitalit.*

*Mandati bankar ose vërtetimi i noterit për pagesën e kapitalit në para - (nëse kapitali është paguar).*

*Vendim i asamblesë së përgjithshme.*

*Aplikim për ndryshime në të dhënat e regjistrimit.*

Në lidhje me aplikimin që kundërshtohet rezulton se:

Aplikimi është paraqitur në QKR nga shtetasja Gjovana Sokoli më datë 21.07.2015 sipas standardit të QKR, Bashkëngjitur, kryerja e pagesave nëpërmjet Union Bank më 22.7.2015.

Bashkë me aplikimin është paraqitur një Kontratë e Blerjes së Kuotave, datë 17.05.2015, lidhur me shitjen dhe blerjen e kuotave të SCHOLZ sh.p.k midis Scholz Internationale Handelsgesellschaft mbH, me seli në Am Bannhof 73457 Essingen, Gjermani dhe Doni Sokolaj, Gjovana Sokolaj, i cili në masën 25% të kapitalit të shoqërisë, shoqëruar me vërtetimin noterial, nga përmbajtja e të cilit rezulton se është konfirmuar ky nënshkrim nga Presidenti i Gjykatës së Landit Unkle dhe vendimi i ortakut të vetëm, i cili ka të reflektuar ndryshimet e ndodhura në shoqëri. Akti përmban një vërtetim noterial, si dhe vulën dhe nënshkrimin e presidentit të Gjykatës së Landit Unkel, i cili ka vërtetuar origjinalitetin e nënshkrimit të noteres Sandra Buhler në Abtsmund dhe vulës së shërbimit.

Aktet e mësipërme janë përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licensuar, nënshkrimet e të cilëve janë vërtetuar nga një noter shqiptar.

Palët paditëse Scholz” Sh.p.k. dhe “Scholz Internationale Handelsgesellschaft” mbH, kanë marrë dënimin për veprimet e mësipërme të regjistrimit dhe duke mos qenë dakord me personin që ka kryer aplikimin, pasi aplikuesja Gjovana Sokolaj nuk ka qenë personi i autorizuar ta kryejë atë, duke pretenduar se dokumentet shoqëruese të aplikimit, të cilat duhet të provojnë të dhënat që regjistrohen nuk plotësojnë kushtet formale të parashikuara në nenin 27 të ligjit 9723, i janë drejtuar me ankim administrativ Drejtorit të Përgjithshëm të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Ankimin e tyre pala paditëse e ka mbështetur në nenet 71, 72, 26, 27 të Ligjit nr. 9723 dhe Kodit të Procedurave Administrative.

Me ankimin administrativ është kërkuar: *Shfuqizimi i regjistrimit të aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07-15; Kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme”.*

Në përgjigje të ankimit administrativ të Scholz sh.p.k dhe “Scholz Internationale Handelsgesellschaft” mbH, me shkresën numër prot. 6796/1 datë 31.07.2015, pala e paditur QKR ka vendosur:

*“...ankimi administrativ pjesërisht pranohet vetëm për të dhënat e regjistruara si: ndryshimi i emrit të shoqërisë, ndryshimi i nenit 5, nenit 6, nenit 7, nenit 14 të statutit të shoqërisë, caktimi i z. Doni Sokolaj si president i asamblesë së ortakëve. Ankimi rrëzohet për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave”.*

Ky akt është regjistruar nga QKR më datë 03.08.2015 me numër regjistrimi CN-189803-08-15, në ekstraktin e Shoqërisë.

Në arsyetimin e tij rezulton se është pranuar ankesa për regjistrimet e kryera pa kërkesës të administratorit të shoqërisë, ndërkohë që është rrëzuar ajo për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave duke qenë se aplikuesja Gjovana Sokolaj, ka pasur të drejtën e aplikimit në cilësinë e ortakes së shoqërisë sipas nenit 26,3 të ligjit për QKR-në.

## Procedura gjyqësore dhe vlerësimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Paditëset shoqëritë “Scholz” Sh.p.k. dhe “Scholz Internationale Handelsgesellschaft” mbH i janë drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë më datë 24.08.2015 duke kërkuar shfuqizimin e pjeshëm të Aktit të QKR-së numër prot. 6796/1, datë 31.07.2015 sa lidhet me rrëzimin e ankimit për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave, në çështjen me numër CN- 159843—07-15 , shfuqizimin e plotë të regjistrimit të aplikimit të kryer nga Gjovana Sokolaj në çështjen me numër CN-159843-07- 15 dhe kthimin e gjendjes së regjistrimit në gjendjen e mëparshme

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit pasi ka thirrur në cilësinë e personit të tretë aplikuesen Gjovana Sokoli, pasi ka shqyrtuar pretendimet e palëve ka vendosur pranimin e kërkesë padisë duke shfuqizuar veprimet e regjistrimit të kryer nga QKR sikurse është përshkruar në pjesën hyrëse të vendimit duke arsyetuar si vijon:

Aktet e përdorura për të kryer regjistrimin sipas nenit 27/4 të ligjit për QKR, nenit 12 të Konventës së Hagës së vitit 1961 dhe VKM nr. 134, datë 07.03.2003 nuk kanë pasur fuqinë juridike për t’u përdorur në territorin e Republikës së Shqipërisë , pasi ato nuk kanë qenë të legalizuara sipas ligjit.

Gjykata ka evidentuar gjithashtu se regjistrimi është bërë në bazë të dokumenteve fotokopje, ndërkohë që dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji.

Ajo ka vlerësuar se dorëzimi i dokumentit shoqërues pranë sporteleve të shërbimit në kopje të panjësuar bëhet nën përgjegjësinë e plotë të personit që e paraqet atë, i cili, nëpërmjet aktit të dorëzimit, konfirmon njësinë e kopjes apo të dokumentit në format elektronik me origjinalin. Në rastin konkret është evidentuar se nuk konfirmohet se dokumentet e dorëzuara nga vetë subjekti që i ka dorëzuar të jenë të njësuara me origjinalin.

### Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit:

Gjykata Administrative e Apelit pasi u njoh me shkaqet e paraqitura në ankim, provat e marra në shqyrtim dhe aktet procedurale arrin në përfundimin se vendimi Nr. 5376. Datë 27.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në zbatim të drejtë të ligjit procedural dhe material që gjen zbatim në rastin konkret dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Duke iu referuar pretendimeve të paraqitura në ankim , gjykata administrative e apelit arsyeton si vijon:

1. Në lidhje me pretendimin e mungesës së legjitimitetit aktiv të administratorit të shoqërisë Scholz sh.p.k dhe “Scholz Internationale Handelsgesellschaft” mbH në ngritjen e padisë, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky pretendim është i pambështetur në ligj për shkak se sipas nenit 71 të ligjit 9723/2007 përcaktohet se çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative ndaj veprimeve apo mosveprimeve të QKR-së për regjistrimet dhe publikimet, sipas dispozitave të këtij ligji, ndërsa sipas nenit 17.a të ligjit nr. 49/2012 përcaktohet se padia mund të ngrihet për shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ.

Në rastin konkret, regjistrimi i kryer në QKR për llogari të shoqërisë Scholz sh.p.k, mbi aplikimin e ortakut të ri të pretenduar të Scholz sh.p.k është një regjistrim që sjell pasoja në gjendjen e shoqërisë dhe ndryshon kuotat e ortakut të vetëm të saj "Scholz Internationale Handelsgesellschaft" mbH dhe në këto rrethana, si administratori i shoqërisë Scholz sh.p.k, si përfaqësues ligjor i saj, ashtu edhe ortaku i vetëm i shoqërisë Scholz Internationale Handelsgesellschaft" mbH , si pronari i saj, kanë interes të ligjshëm për të kundërshtuar një regjistrim të kryer nga QKR, me të cilin transferohen të drejtat e pronësisë.

2. Në lidhje me çështjen e shtruar për diskutim, nëse regjistrimi i kryer nga pala e paditur QKR me Nr. QK-159843-07-15, datë 24.07.2015 , në bazë të aplikimit të kryer nga aplikuesja, person i tretë në këtë gjykim Gjovana Sokolaj me të cilin janë pasqyruar ndryshime në të dhënat e regjistrimit për shoqërinë Scholz sh.p.k, me ortak të vetëm "Scholz Internationale Handelsgesellschaft" mbH është një regjistrim i kryer në përputhje me nenin 27 të ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për qendrën kombëtare të regjistrimit" apo jo, Gjykata administrative e apelit duke pasur në konsideratë provat e paraqitura për shqyrtim dhe pretendimet respektive të palëve, të analizuara në raport me përcaktimet e nenit 27 të ligjit 9723/2007 , ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja" dhe VKM-së nr. 134, datë 07.03.2003 arrin në përfundimin se regjistrimi nuk është kryer në përputhje me ligjin.

sipas nenit 27. 4 të ligjit nr. 9723/2007 me titull "Aplikimi dhe forma e dokumenteve shoqëruese" përcaktohet se:

*"1. Regjistrimi kryhet me dorëzimin e aplikimit përkatës, të cilit i bashkëngjiten dokumentet shoqëruese, që provojnë të dhënat që regjistrohen.*

*2. Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të panjësuar me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit dhe të jenë hartuar në formën e përcaktuar nga legjislacioni përkatës apo nga dispozitat e këtij ligji.*

*...4. Dokumentet shoqëruese duhet të jenë në gjuhën shqipe. Së bashku me dokumentin shoqërues në shqip, aplikanti mund të depozitojë edhe përkthimin e vërtetuar në gjuhë të huaj. Aktet private dhe dokumentet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. ...*

Në analizë të kësaj dispozitë arrihet në konkluzionin se një dokument privat apo zyrtar, i një juridiksioni të huaj, pra lëshuar apo përpiluar jashtë shtetit shqiptar, që të shërbejë si shkak për kryerjen e një regjistrimi në bazë të një aplikimi duhet që të jetë i shoqëruar me përkthimin në gjuhën shqipe dhe të legalizohet sipas ligjeve në fuqi.

Mënyra e legalizimit të një dokumenti të lëshuar nga autoritetet e huaja, apo i përpiluar në një vend të huaj rregullohet sipas ligjit nr. 9060, datë 8.5.2003 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në "Konventën për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja" apo sipas VKM-së nr. 134, datë 07.03.2003.

Në bazë të Konventës së sipërpërmendur, dokumentet pajisen me një vulë Apostille nga autoriteti kompetent i vendit ku janë lëshuar dhe më pas mund të përdoren në institucionin përkatës të vendit pritës.

Sipas nenit 12 të Konventës përcaktohet se:

*“Çdo shtet, që nuk përmendet në nenin 10, mund të aderojë në këtë Konventë pas hyrjes në fuqi të saj në përputhje me nenin 11 paragrafi i parë. Instrumenti i aderimit depozitohet pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme të Hollandës.*

*Ky aderim do të ketë efekt vetëm në lidhje me marrëdhëniet midis shtetit aderues dhe Shteteve Palë, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtim për këtë aderim brenda gjashtë muajve nga marrja e lajmërimit, parashikuar nga neni 15 pika d. Për çdo kundërshtim duhet të njoftohet Ministria e Punëve të Jashtme të Hollandës.*

*. Konventa hyn në fuqi, ndërmjet shtetit aderues dhe shteteve, të cilat nuk kanë paraqitur kundërshtime për këtë aderim ditën e gjashtëdhjetë pas përfundimit të periudhës 6 - mujore, përmendur në paragrafin më sipër.”*

Gjermania, Belgjika, Spanja, Greqia dhe Italia kanë paraqitur kundërshtime për aderimin e Shqipërisë në këtë konventë brenda afatit 6 mujor të parashikuar në nenin 12, 2, të Konventës, afat i cili përfundonte më 10 mars 2004 dhe për pasojë fillimisht konventa nuk ka hyrë në fuqi mes Shqipërisë dhe këtyre 5 shteteve.

Më vonë, më 21 dhjetor 2015, Belgjika e ka tërhequr kundërshtimin, ndërsa Italia e ka tërhequr atë më 26 maj 2011, që do të thotë se konventa ka hyrë në fuqi me këto shtete nga data e deklarimit të tërheqjes së kundërshtimit.

Këto të dhëna rezultojnë nga faqja elektronike zyrtare e Konferencës së Hagës. <https://www.hcch.net/fr/instruments/conventions/statustable/notifications/?csid=43&disp=type>.

Duke qenë se Konventa e mësipërme nuk ka hyrë në fuqi me Gjermaninë, legalizimi i dokumenteve shqiptare për përdorim në këtë vend, si dhe i dokumenteve të këtij vendi për përdorim në Shqipëri do të bëhet sipas VKM-së Nr. 134, datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumenteve të lëshuara në Republikën e Shqipërisë, për përdorim jashtë vendit dhe të dokumenteve të huaja, për përdorim brenda vendit.”

Sipas pikës 4 të këtij vendimi përcaktohet se: *“Dokumentet e autoriteteve të huaja, që do të përdorën brenda vendit, legalizohen në përfaqësitë e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, ndërsa dokumentet e legalizuara nga përfaqësitë e akredituara në Tiranë, legalizohen në Ministrinë e Punëve të Jashtme.”*

Duke pasur parasysh se dy dokumentet e paraqitura për regjistrim në QKR nga personi i tretë Gjovana Sokoli nuk ishin të legalizuara nga autoritetet e përfaqësisë diplomatike apo konsullore në Gjermani, por vetëm nga autoriteti kompetent gjerman i deklaruar si i tillë për efekt të zbatimit të Konventës së Hagës “Për heqjen e kërkesës për legalizimin e dokumenteve zyrtare të huaja të vitit 1961”, konventë , e cila nuk zbatohet mes Shqipërisë dhe Gjermanisë, arrihet në konkluzionin se ato nuk plotësonin elementët formalë të vlefshëm për kryerjen e regjistrimit në QKR.

Pas verifikimit të elementëve formalë të aplikimit sipas nenit 54.1.c të ligjit nr. 9723/2007 , QKR procedon me regjistrimin sipas nenit 55 ose me refuzimin e regjistrimit sipas nenit 57 të ligjit të sipërpërmendur.

Nga përmbajtja e ligjit rezultonte refuzimi i regjistrimit nuk mund të pengojë kryerjen e një aplikimi të ri, në rast se aplikimi plotëson elementët formalë sipas neneve 27 e 54.1 të Ligjit nr. 9723/2007.

3. Në lidhje me pretendimin e paraqitur për thirrjen në gjykim të shtetasit Doni Sokolaj, në favor të të cilit është kryer regjistrimi që kundërshtohet, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ky pretendim nuk është i mbështetur në ligj, për shkak se ky shtetas nuk ka paraqitur aplikim në cilësinë e ortakut, me padinë në shqyrtim nuk kundërshtohet vlefshmëria e përmbajtjes së aktit të paraqitur për regjistrim, por mungesa e elementëve formalë të tij, si kusht për regjistrim në QKR.

Ky shtetas në cilësinë e ortakut, mund të paraqesë aplikim për regjistrimin e veprimeve juridike, që lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet në përputhje me nenin 26.3 dhe nuk cenohet nga fshirja e një regjistrimi të kryer mbi bazën e një aplikimi që nuk plotësonte kushtet formale.

Pretendimet e tjera në lidhje me origjinalitetin e dokumenteve dhe njehsimin e tyre janë relevante për çështjen duke qenë se u konstatua mungesa e elementit formal të legalizimit dhe vetë ligj njeh mundësinë e paraqitjes së dokumenteve të panjësuar me origjinalin. ( neni 27.2 i ligjit për QKR-në).

Sa më sipër , arrihet në përfundimin se akti Nr. 6796/ 1 datë 31.07.2015 i QKR-së , me të cilin është rrëzuar ankimi i paditëseve për shfuqizimin e regjistrimit numër CN-159843-07-15, datë 24.07.2015 për pjesën e regjistrimit të kontratës së shitblerjes së kuotave është një akt që vjen në kundërshtim me ligjin pasi, në këtë rast pala e paditur duhet të konstatonte mungesën e elementëve formalë të aktit që kërkohej të regjistrohej, duke qenë se nuk ishte i legalizuar sipas akteve ligjore në fuqi e për pasojë të korrigjonte veprimin e regjistrimit të nëpunësit të QKR-së duke proceduar me pranimin e ankimit dhe fshirjen e regjistrimit, si një regjistrim, i cili duhej të ishte refuzuar të kryhej sipas neneve 27.4, 54.1.c dhe 57 të ligjit nr. 9723/2007 "Për QKR" i ndryshuar.

Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, Gjykata Administrative e Apelit bazuar në nenin 50 germa "b" të ligjit Nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", vlerëson se vendimi Nr. 5376, datë 27.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë duhet të lihet në fuqi, si një vendim i drejtë, i mbështetur në prova dhe në ligj.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 50 germa "b" të ligjit Nr. 49/2012 "Për organizimin edhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### **VENDOSI**

- Lënien në fuqi të vendimit Nr.5376, datë 27.10.2015 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve duke filluar ky afat nga dita e njoftimit të këtij vendimi.  
U shpall, sot në Tiranë, më datë 26.05.2016.

**ANËTARE**  
**BLERONA HASA**  
**D.V**

**ANËTAR**  
**ARTUR MALAJ**  
**D.V**

**Vertetohet njesia me origjinalin**

*Kancelari*  
*Leonard Stevcaj*  
*Stevo*

